

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më datë 15.05.2024, bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” – i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të Ligjit Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe statutin e shoqërisë “Albanian Development Company ADC” SH.P.K, nënshkruhet kjo “kontratë për shitje kuotash” si më poshtë vijon:

Neni 1 Palët Kontraktuese

1. **Z. Theodhoro Çami**, shtetas shqiptar, lindur në Gjirokastrë, më datë 06.09.1981, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nga letërnjoftimi me nr. personal I10906013F, nga këtu e më poshtë referuar si “**Shitësi**”.
- dhe
2. **Z. Eneid Lika**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 21.05.1980, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nga letërnjoftimi me nr. Personal I00521201V, nga këtu e më poshtë referuar si “**Blerësi**”.

Neni 2 Objekti i Kontratës

- 2.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja prej Shitësit kundrejt Blerësit e 30% (tridhjetë përqind) të pjesëve/kuotave të kapitalit, që Shitësi zotëron në shoqërinë “Albanian Development Company ADC” SH.P.K (NUIS L52104227K).
- 2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, struktura e pronësisë mbi kapitalin themeltar të shoqërisë do të jetë:

Ortakët	Numri i kuotave	Përqindja e pronësisë mbi kapitalin
Theodhoro Çami	1	70%
Eneid Lika	1	30%

Neni 3 Çmimi i Shitjes dhe mënyra e pagesës

- 3.1 Çmimi total i shitjes që do t’i paguhet Shitësit nga Blerësi, është vlera **50000 (pesëdhjetë mijë euro) Euro**.
- 3.2 Çmimi i përcaktuar në nenin 3.1 më sipër, do të paguhet prej Blerësit brenda një afati kohor 5 vjeçarë me këste në diskrecion të palës Blerëse nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4
Kalimi i Pronësisë

- 4.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate prej palëve, Blerësi fiton pronësinë e plotë mbi kuotën (kapitalin) objekt të kësaj kontrate, duke u shndërruar në ortak, zotërues i 1 (një) kuotë që përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 5
Detyrimet e Shitësit

- 5.1 Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotës (kapitalit) objekt të kësaj kontrate, që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë “Albanian Development Company ADC” SH.P.K, kuotë që menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate i kalon Blerësit.
- 5.2 Shitësi garanton Blerësin se kuota objekt i kësaj kontrate, nuk është lënë peng, në dorëzani apo të rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i ligjshëm i saj dhe gëzon të drejta të plota mbi të.

Neni 6
Detyrimet e Blerësit

- 6.1 Blerësi merr përsipër të paguaj çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 7.1 Kjo kontratë hartohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 7.2 Çdo mosmarrëveshje mes palëve do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 8
Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

- 7.1 Kjo kontratë përgatitet në 2 (dy) kopje, të dyja të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.
- 7.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

PALËT

SHITËSI
Z. Theodhoro Çami

BLERËSI
Z. Eneid Lika

